



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA E QYTETIT  
KORÇË

## KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

### VENDIM

Nr. 120 datë 11.12. 2009

### Për dhënien e ndihmës familjes të dëmtuar nga zjarri.

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sek. i Shërbimeve Komunitare dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike, “ Për dhënien e ndihmës financiare për familjen e dëmtuar”, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.206 datë 26.03.1998, i ndryshuar, “ Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësish” Ligjit nr.8652 datë 31.07.2000 “ Për organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” neni 32, gërma dh, në ligjin nr.9936 dt. 26.06.2008. “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë ” në ligjin nr 10025 dt. 27.11.2008 “ Për buxhetin e vitit 2009, Udhëzimin MF nr 2 dt. 12.01.2009 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2009” si dhe në VKB nr 12 dt 13.02.2009 “ Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2009”

### VENDOSI

1. Të ndihmohet familja e qytetarit Seladin Mimini e cila u dëmtua nga zjarri i rënë në hyrjen e pallatit nr.08, kati i parë e ndodhur në lagjen nr. 15, Rruga “Viktor Eftimiu”. Familja ditën e aksidentit ka qënë e përbërë 6 (gjashtë) persona, e konfirmuar kjo nga Zyra e Gjëndjes Civile. Masa e ndihmës për dëmin në pajisje dhe orendi do të jetë si me poshtë:

5 persona x 20 000 = 100 000 lek

2. Ky fond do të përballohet nga fondi i emergjencave civile të miratuar në buxhetin e Bashkisë për vitin 2009 me strukturë buxhetore:

00 04980 05 Art. 6060000 Vlerë 100 000 lek

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës Sek. Shërbimeve Komunitare dhe Emergj.Civile dhe Drejtoria Juridike.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

Gjergji PENDAVINJI